Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/21
Datë: 29.01.2021

Në mbështetje të nenit 4 dhe 23 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës nr. 03/L-189, nenit 6 dhe 16 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare nr. 03/L-060, si dhe Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë nr. 35/2014, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 30.12.2020 nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Akreditohet** Instituti për aftësimin profesional dhe përkrahje të punësimit "Dituria" me adresë Rr. Rezistenca e Vërrinit, pn. Prizren, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 30.12.2020 deri 29.12.2023, me kualifikimin e aprovuar në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).

2. **Murator dhe punëtorët e ngjashëm**, Niveli III sipas KKK.

Për modulet:

2.1 Moduli 1, Bazat e ndërtimtarisë dhe mbrojtja në punë, me 24 orë/ 1 kredi të AAP.

2.2 Moduli 2, Leximi, aplikimi dhe matjet teknike, me 36 orë/2 kredi të AAP.

2.3 Moduli 4, Muratimi me blloqe, tulla dhe elemente tjera, me 204 orë/10 kredi.

2.4 Moduli 5, Muret ndarëse nga rigipsi, 66 orë/3 kredi të AAP.

3. Institucioni mund të realizojë procesin mësimor deri në gjashtë (6) kandidatë për një modul. Institucioni gjatë një ciklit të trajnimit mund të organizojë deri në 2 module në të njejtën kohë.

4. Nuk validohen modulet:
5.1 Moduli 3, Kallupimi dhe armirimi i elementeve të betonit, me 154 orë/ 4 kredi të AAP,
5.2 Moduli 6, Parimet e përgjithshme të implementimit të punëve finale, me 90 orë/8 kredi të AAP,

5. Shfuqizohet vendimi i Këshillit Drejtues të AKK-së me datë 04.03.2020.

7. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së Institutit për aftësim profesional dhe përkrahje të punësimit "Dituria", për akreditim dhe rekomandimeve të dala nga Raporti i vlerësimit të ekipit të ekspertëve për aneks akreditim, si dhe Raporti i ekipit të ekspertëve për Akreditim të institucionit, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për Akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e Vetëvlerësimit; Vizitën në institucionin/ofruesin aplikues, si dhe dokumente tjera shtesë.

Pas trajtimit në detaje nga ekipi i ekspertëve të dokumentacionit të sipërpërmendur dhe të gjeturave nga vizita, ekipi i ekspertëve në raportin e hartuar dha vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje. Mbi këtë bazë, Këshilli Drejtues, bazuar në kompetencat e tij, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga hapësira e ndërtesës së prezantuar, është vërejtur që është e pamundur që të bëhet realizimi i këtij kualifikimi në tërësi, në kuadër të objektit. Pikërisht për këtë arsye, në kushtet e këtij objekti është rekomanduar që në hapësirat e prezantuara, të realizohet procesi mësimor vetëm për modulet 1,2,4 dhe 5, dhe jo për modulin 3 dhe 6 të këtij kualifikimi. Realizimi i këtyre moduleve do të bëhet duke respektuar kriteret strikte si dhe rekomandimet e dhëna në këtë raport.

Meqenëse për këto dy module (3 dhe 6) të këtij kualifikimi, sipas standardeve dhe kritereve të AKK kërkohen hapësira më të mëdha, hapësira këto të cilat Instituti për aftësimin profesional dhe përkrahje të punësimit "Dituria" nuk i posedon dhe bazuar në rekomandimin e ekspertëve, KD i AKK vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me Nr. 35/2014. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit

Vendimi u dërgohet:

1. Institutit për aftësimin profesional dhe përkrahje të punësimit "Dituria";
2. Arkivit të AKK.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar i KD së AKK